

VENDIM
Nr. 536, datë 30.12.2021

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT PËR
NDRYSHIM TË TARIFAVE TË SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME
KONISPOL**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 21 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102); vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015, “Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 40); vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015, “Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 41); vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015, “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 42),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

Në mbledhjen e datës 30.12.2021, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike mbi kërkesën e Ujësjiellës-Kanalizimeve Konispol sh.a., për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime,

KONSTATOI SE:

Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Konispol është licencuar me vendimin e KKRR-së nr. 39, datë 1.6.2018, “Për licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Konispol”, për shkak të rinovimit të licencës pas përfundimit afatit.

Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Konispol ka aplikuar pranë ERRU-së për nivel të ri tarifor, për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, me shkresën nr. 123 prot., datë 14.12.2021, me lëndë “Lista e dokumentacionit të nevojshëm për unifikimin e tarifave të ujit për UK Konispol”.

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria UK Konispol është plotësuar sipas Metodologjisë së Vendosjes së Tarifave.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i shoqërisë UK Konispol është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në vendimin nr. 40 dhe kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Konispol për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë.

2. Drejtoria Tekniko-Ekonomike detyrohet të njoftojë shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Konispol dhe Bashkinë Konispol për vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani